

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Bazat e Auditimit të
Brendshëm
(zgjidhjet)**

B2

ID Nr.

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Udhëzime/Instructions:

1. MOS E HAPNI DERISA T'JU LEJOHET PREJ MBIKËQYRËSIT
Do Not Open Until Your invigilator Allows You to Do So.
2. ËSHTË E DETYRUESHME PËRGJIGJA E GJITHA PYETJEVE
All Questions Are Mandatory
3. KOHA E LEJUAR ËSHTË 3 ORË
Time Allowed is 3 Hours
4. EMRI JUAJ NUK DUHET TË PARAQITET NË ASNJË FLETË
TË KËTIJ PROVIMI.
Your name should appear nowhere in this test.

Data 01.02.2024

CONTENT/ PËRMBAJTJA

Pjesa	Maksimumi i dhënë	Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK PIKËT E DHËNA
1. Pyetje (50 x 2 pikë)	100	
Gjithsej	100	

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

- Informacioni i detajuar i biletave të linjave ajrore, duke përfshirë klasën e tarifës, datën e blerjes dhe opsionet më të ulëta të mundshme të tarifave, siç përshkruhet në politikën e udhëtimit të kompanisë, merret dhe raportohet tek menaxhmenti i departamentit kur punonjësit blejnë bileta ajrore nga agjensionet e autorizuar të udhëtimit nga kompania. Një raport i tillë ofron informacion për:
 - Cilësinë e performancës në lidhje me politikën e udhëtimit të kompanisë.**
 - Identifikimin e kostove të nevojshme për të përpunuar të dhënat e raportit të shpenzimeve të punonjësve.
 - Krahasimin e buxhetit aktual me buxhetin e parashikuar të departamentit.
 - Të mbështetur zbritjet e shpenzimeve të biznesit të punëdhënësit.
- Menaxhmenti pohoi se standardet e performancës që auditorët përdorën për të vlerësuar performancën e operimit ishin të papërshtatshme. Standardet e shkruara të performancës që ishin vendosur nga menaxhmenti ishin të paqarta dhe duhej të interpretoheshin nga auditori. Në raste të tilla, auditorët mund të përmbushin përgjegjësinë e tyre të kujdesit të duhur profesional duke:
 - Siguruar veten se interpretimet e tyre janë të arsyeshme.
 - Siguruar veten se interpretimet e tyre janë në përputhje me praktikat e industrisë.
 - Rënë dakord me të audituarit për standardet e nevojshme për të matur performancën.**
 - Përfshirë kundërshtimet e menaxhmentit në raportin e auditimit.
- Një institucion i madh financiar disa vjet më parë krijoi një kod të mirësjelljes dhe u shpërndau kodin e mirësjelljes të gjithë zyrtarëve dhe punonjësve të tij. Identifikoni qasjen më të mirë të auditimit për t'i ofruar komitetit të auditimit nivelin më të lartë të sigurisë për implementimin e kodit të sjelljes:
 - Vlerësoni plotësisht gjithë-përfshirjen e kodit dhe pajtueshmërinë me të, dhe raportoni rezultatet te komiteti i auditimit.**
 - Vlerësoni plotësisht praktikat e ndërmarrjes për pajtueshmërinë me kodin dhe raportoni tek komiteti i auditimit.
 - Rishikoni aktivitetet e punonjësve për pajtueshmëri me dispozitat e kodit dhe raportoni tek komiteti i auditimit.
 - Kryeni teste në transaksione të ndryshme të punonjësve për të zbuluar shkelje të mundshme të kodit të mirësjelljes.
- Cila nga sistemet e mëposhtme të kontrollit të menaxhimit mat performancën në aspektin e fitimit operativ minus kosto e kapitalit të investuar në pasuritë e prekshme?
 - Sistemi i menaxhimit të librit të hapur (open-book).
 - Sistemi ekonomik me vlerë të shtuar.**
 - Sistemi i koston së bazuar në aktivitete.
 - Sistemi i vlerës së shtuar të tregut.

5. Cila nga pohimet e mëposhtme është e vërtetë në lidhje me koordinimin e përpjekjeve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm?
- Shefi ekzekutiv i auditimit (CAE) nuk duhet t'i japë informacione për veprime të paligjshme një auditori të jashtëm sepse auditorëve të jashtëm mund t'u kërkohej të raportojnë çështjen në Bord dhe / ose agjencitë rregullatore.
 - Pronësia dhe konfidencialiteti i letrave të punës të auditorit të jashtëm ndalojnë shqyrtimin e tyre nga auditorët e brendshëm.
 - Nëse auditorët e brendshëm u japin ndihmë auditorëve të jashtëm në lidhje me auditimin vjetor, puna e auditimit nuk i nënshtrohet Standardeve Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm.
 - CAE duhet të përcaktojë që ndjekja e duhur dhe veprimi korrigjues është ndërmarrë nga menaxhmenti kur kërkohej për çështje të diskutuara në letrën e menaxhmentit të auditorit të jashtëm.**
6. Departamenti i auditimit të brendshëm ka përfunduar një hetim mashtrimi që zbuloi një ndikim negativ material të pazbuluar më parë në pozicionin financiar dhe rezultatet e operacioneve për dy vjet në të cilat pasqyrat financiare janë lëshuar tashmë. Shefi ekzekutiv i auditimit duhet menjëherë të informojë:
- Firmën e auditimit të jashtëm përgjegjëse për pasqyrat financiare të prekura nga zbulimi
 - Menaxhmentin dhe komitetin e auditimit të bordit të drejtorëve.**
 - Agjensionet përkatëse qeveritare ose rregullatorët
 - Departamentin e kontabilitetit të brendshëm i cili përfundimisht është përgjegjës për bërjen e shënimeve korrigjuese.
7. Standardet e IIA kërkojnë që drejtori i auditimit të kërkojë miratimin e menaxhmentit dhe pranimin nga bordi të një statuti zyrtar të shkruar për departamentin e auditimit të brendshëm. Qëllimi i këtij statuti zyrtar është që:
- Mbron departamentin e auditimit të brendshëm nga ndikimi i jashtëm i padrejtë.
 - Përcakton qëllimin, autoritetin dhe përgjegjësinë e departamentit të auditimit të brendshëm.**
 - Përcakton qartë marrëdhëniet midis auditimit të brendshëm dhe të jashtëm.
 - Vendos statusin e drejtorit si një staf ekzekutiv.
8. Kriteret kryesore për përcaktimin e mjaftueshmërisë së dokumenteve të punës mund të gjenden në:
- Standardet e IIA.**
 - Kodi i Etikës i IIA.
 - Udhëzime praktike.
 - Akti i Praktikave të Korrupsionit.

9. Bazuar në Standardet e IIA, programi i zhvillimit të stafit të një departamenti të auditimit të brendshëm do të jetë i mangët nëse punonjësit individualë:
- A. Janë deleguar një larmi të madhe detyrash për të kryer.
 - B. Pritet të analizojnë ngjarjet aktuale mbi një bazë të pavarur.
 - C. Janë caktuar në mbikëqyrës të ndryshëm për secilën punë.
 - D. Vlerësohen zyrtarisht një herë në dy vjet.**
10. Auditimi i brendshëm është përgjegjës për raportimin e mashtrimit tek menaxhmenti i lartë ose bordi kur:
- a) Janë raportuar aktivitetet e dyshimta në auditimin e brendshëm.
 - b) Transaksionet e parregullta janë identifikuar dhe janë nën hetim.
 - c) Shqyrtimi i të gjitha transaksioneve të dyshuara lidhur me mashtrimin ka përfunduar.
 - d) Incidenca e mashtrimit të një shume materiale është vërtetuar në një siguri të arsyeshme.**
11. Cila nga pikat e mëposhtme ka të ngjarë të pasqyrojë ndryshimet midis politikave të një operacioni relativisht të vogël dhe relativisht të madh të auditimit të brendshëm? Politikat për operacionin e madh duhet:
- a) Përcaktojnë qëllimin dhe statusin e auditimit të brendshëm
 - b) Të përmbajnë detaje të konsiderueshme**
 - c) Përmbajnë autoritetin për të kryer auditime
 - d) Të jetë specifik për sa i përket aktiviteteve që duhen ndjekur
12. Cila nga kontrollet e të dhënave hyrëse (input controls) ose kontrolleve të modifikimit do të zbulonte lloje të caktuara të gabimeve brenda fushës së shumës së pagesës së një transaksioni:
- A. Kontrollimi i limitit.**
 - B. Numërimi i regjistrimeve.
 - C. Kontrolli echo.
 - D. Kontrollimi i shifrës.
13. Për t'u siguruar që mallrat e pranuar janë të njëjta me ato të paraqitura në faturën e blerjes, një sistem i kompjuterizuar duhet të:
- A. Mbaj në kontroll vlerën totale të stoqeve.
 - B. Llogarit totalin e grumbulluar për çdo hyrje.
 - C. Përdorë kontrollin e shifrave në numrat e llogarisë.
 - D. Harmonizojë fushat e zgjedhura të faturës së blerjes me mallrat e pranuar.**

14. Ju jeni transferuar nga departamenti i thesarit në departamentin e auditimit të brendshëm të së njëjtës kompani muajin e kaluar. Zyrtari kryesor financiar i kompanisë ka sugjeruar që meqenëse keni njohuri të konsiderueshme në këtë fushë, do të ishte një ide e mirë që ju të filloni menjëherë një auditim të departamentit të thesarit. Në këtë rrethanë ju duhet:
- Pranoni angazhimin e auditimit dhe filloni menjëherë punën
 - Diskutoni nevojën për një auditim të tillë me ish-epërmjetin tuaj në departamentin e thesarit.
 - Sugjeroni që auditimi të bëhet nga një anëtar tjetër i stafit të auditimit të brendshëm**
 - Oferta për të përgatitur një program auditimi por sugjeroni që intervistat me ish-bashkëpunëtorët tuaj të bëhen nga anëtarët e tjerë të stafit të auditimit të brendshëm
15. Kodi i etikës i një organizate profesionale përcakton:
- Detajet organizative të organit drejtues të profesionit
 - Një listë të veprimtarive të paligjshme që u përshkruhen anëtarëve të profesionit
 - Kriteret me të cilat vlerësohet dhe matet performanca e veprimtarive profesionale
 - Standarde të gjera të sjelljes për anëtarët e organizatës**
16. Standardet e IIA kërkojnë që departamenti i auditimit të brendshëm të ofrojë siguri që auditimet e brendshme mbikëqyren siç duhet në mënyrë që të:
- Krijohen auditime profesionale me cilësi të lartë të vazhdueshme.**
 - Siguroj produktivitetin të lartë të raportimit të auditimit.
 - Siguroj trajnim efikas të stafit të auditimit.
 - Përcaktoj që programi i auditimit po ndiqet pa devijime.
17. Konferenca dalëse ndihmon për të siguruar që:
- Objektivat e auditimit dhe fushëveprimi i punës së auditimit janë të njohura nga i audituari.
 - I audituari e kupton programin e auditimit.
 - Nuk ka pasur keqkuptime apo keqinterpretime të fakteve.**
 - Identifikohet lista e personave që do të marrin raportin përfundimtar.
18. Cila nga pohimet e mëposhtme pasqyron më saktë përgjegjësitë e shefit ekzekutiv të auditimit (CAE) për menaxhimin dhe zhvillimin e personelit siç pasqyrohet në Standardet e IIA?
- Shefi ekzekutiv i auditimit është përgjegjëse për përzgjedhjen e individëve të kualifikuar, por nuk ka përgjegjësi të qartë për ofrimin e mundësive të edukimit të vazhdueshëm për auditorin e brendshëm.
 - Shefi ekzekutiv i auditimit është përgjegjës për kryerjen e një rishikimi vjetor të performancës së çdo auditori të brendshëm, por nuk ka përgjegjësi të qartë për këshillimin e auditorëve të brendshëm për performancën dhe zhvillimin e tyre profesional.
 - Shefi ekzekutiv i auditimit është përgjegjëse për përzgjedhjen e individëve të kualifikuar, por nuk ka përgjegjësi të qartë për përgatitjen e përshkrimeve të punës.

D. Shefi ekzekutiv i auditimit është përgjegjës për zhvillimin e përshkrimeve formale të punës për stafin e auditimit, por nuk ka përgjegjësi të qartë për administrimin e programit të kompensimit të korporatës.

19. Plani i veprimtarisë së auditimit të brendshëm do të përqendrohet në cilën nga fushat e mëposhtme?
- a) Aty ku ndryshimi midis rrezikut aktual dhe rrezikut të biznesit është i madh.
 - b) Aty ku ndryshimi midis rrezikut të vetvetishëm dhe rrezikut të mbetur (rezidual) është i madh.**
 - c) Aty ku ndryshimi midis rrezikut të planifikuar dhe rrezikut të performancës është i madh.
 - d) Aty ku ndryshimi midis rrezikut absolut dhe rrezikut relativ është i madh.
20. Regjistrat e rreziqeve përshkruajnë lidhje direkte midis cilave nga sa vijon?
- a) Pranimi i rrezikut dhe shmangia e rrezikut
 - b) Kategoritë e rrezikut dhe aspektet e rrezikut**
 - c) Caktimi i rrezikut dhe shpërndarja e rrezikut
 - d) Kufizimi i rrezikut dhe rreziku i përhapjes
21. Karta e komenteve e mbushur nga një klient në një restorant është një pajisje kontrolli e përdorur nga menaxhmenti për të përmirësuar nivelin e shërbimit dhe cilësinë e ushqimit. Kontrollat e këtij lloji klasifikohen si:
- a) Kontrollat paraprake
 - b) Kontrollat drejtuese
 - c) Kontrollat e njëkohshme
 - d) Kontrollat reaguese (feedback)**
22. Menaxhmenti i një organizate jofitimprurëse ka monitoruar shpenzimet dhe është e shqetësuar për shkak se pagesat për disa furnitorë duket të jenë jashtëzakonisht të larta. Shumica e blerjeve bëhen përmes funksionit të blerjes, i cili organizohet rreth tre blerësve, secili me fusha të përcaktuara blerëse. Agjentët e blerjeve vendosin urdhër-blerjet dhe marrin kopje të raporteve të pranimit për të siguruar që mallrat janë pranuar. Ata i rishikojnë raportet dhe i krahasojnë ato me urdhër-blerjet dhe me miratimin e tyre për pagesë përpara se t'i regjistrojnë në llogaritë e pagueshme. Të gjitha faturat e furnitorëve dërgohen drejtpërdrejt në llogaritë e pagueshme edhe pse raportet e pranimit të parë kalojnë nëpër agjentët blerës. Organizata ka një politikë që kërkon tre oferta për të gjitha blerjet që tejkalojnë 10,000€.

Menaxhmenti ka kërkuar që auditori të hetojë mundësinë e shantazheve që i bëhen një agjenti të blerjeve. Cila nga procedurat e mëposhtme do të ishte më pak efektive në adresimin e shqetësimit të menaxhmentit?

A. Konfirmimi i të gjitha kushteve të kontratës me furnitorët.

B. Analizimi, nga agjentët e blerjeve, i të gjitha rritjeve të kostos së mallrave të prokuruar nga furnitorët specifikë.

- C. Merrja e një mostre statistikore të mallrave të blera dhe krahasimi i çmimit të blerjes për mallrat me ato të burimeve të tjera të mallrave të ngjashme, siç janë kompanitë apo katalogët e tjerë.
- D. Vëzhgimi i çdo ndryshimi në mënyrën e jetesës ose në zakonet individuale të konsumit të agjentëve të përfshirë të blerjeve.

23. Petriti dhe Andi kishin njohur njëri-tjetrin për shumë vite. Ata ishin bërë miq të mirë që në kolegji, ku të dy diplomuan në kontabilitet. Pas diplomimit, Petriti mori në mbikëqyrje biznesin e familjes nga babai i tij. Familja e tij kishte një biznes ushqimor për disa breza. Kur Andi kishte vështirësi në gjetjen e një pune, Petriti i ofroi atij punë në dyqanin e familjes. Andi dëshmoi të qenit një punonjës shumë i aftë. Ndërsa Andi demonstroi aftësitë e tij, Petriti filloi të delegonte gjithnjë e më shumë përgjegjësi ndaj tij. Pas një periudhe kohore, Andi po kryente të gjitha autorizimet dhe funksionet e përgjithshme të kontabilitetit për çeqet, paratë, stoqet, dokumentet, regjistrimet dhe harmonizimet e deklaratave bankare.

- I. Andi u konsiderua plotësisht i besueshëm dhe trajtoi të gjitha funksionet financiare. Askush nuk e kontrollonte punën e tij. Petriti vendosi të zgjerojë biznesin dhe hapi disa dyqane të reja.
- II. Petriti trajtonte gjithmonë problemet më urgjente ... profesorët e tij të kolegjit e kishin quajtur "menaxher i krizës". Andi e ndihmonte me problemet kur punët e tjera të tij i lejonin kohë. Ndonëse ishte i suksesshëm në punë, Andi kishte vështirësi me problemet financiare personale.
- III. Në fillim, shumat që Andi vodhi ishin të vogla. Ai as nuk u shqetësua për të bërë bilancin e llogarive. Por Andi u bë lakmitar. "Sa e lehtë është të marrësh para," tha ai. Ai ndjeu se ai ishte një anëtar kritik i ekipit të biznesit, dhe se ai kontribuoi shumë më shumë në suksesin e kompanisë sesa ishte përfaqësuar nga paga e tij.
- IV. Do të duheshin dy ose tre vetë për të më zëvendësuar, ai shpesh mendonte për vetveten. Ndërsa shumat bëheshin çdo herë e më të mëdha, ai bëri bilancin e librave.
- V. Për shkak të këtyre aktiviteteve, Andi ishte në gjendje të blinte një makinë të shtrenjtë dhe të merrte familjen e tij në disa udhëtime çdo vit.
- VI. Ai gjithashtu u bashkua me një klub të shtrenjtë të vendit. Gjithsesi, gjërat ndryshonin në shtëpi. Familja e Andit vuri re se shpesh ai ishte argumentues dhe në raste të tjera shumë në depresion.
- VII. Mashtrimi vazhdoi për gjashtë vjet. Çdo vit biznesi performoi gjithnjë e më keq. Në vitin e kaluar dyqanet humbën mbi 200,000 €. Banka e Petritit kërkoi një auditim. Andi u rrëfye kur mendoi se auditorët kishin zbuluar përvetësimet e tij.

Kur diskutohen mashtrimet, shpesh janë identifikuar presionet, mundësitë dhe racionalizimet që shkaktojnë/lejojnë një keqbërës që të kryejë mashtrimin. Gjithashtu janë studiuar simptomat e mashtrimit.

Numri (I), " Andi u konsiderua plotësisht i besueshëm ...," është një shembull i një:

- A. Simptome të dokumentuar.
- B. Presioni të situatës.
- C. Mundësie për të kryer mashtrimin.**
- D. Simptome fizike.

24. "Treguesit e pranisë" janë kushte që tregojnë se ka një mundësi më të lartë të ndodhjes së mashtrimeve. Cili nga elementet e mëposhtme nuk do të konsiderohet një tregues i tillë?

- a) Një individ ka mbajtur të njëjtën punë të pagesave me para të gatshme për një periudhë të gjatë kohore pa rotacion nëpër detyra të tjera.
- b) Menaxhmenti ka deleguar ndaj vartësve autoritetin për të bërë blerje deri në një kufi të caktuar të vlerës monetare.**
- c) Një individ i cili është përgjegjës për letrat me vlerë që mbahen për qëllime tregtimi, është përgjegjës edhe për bërjen e blerjeve, edhe për regjistrimin e blerjeve në fjalë në librat kontabël, edhe për raportimin e të gjitha mospërputhjeve ose fitimeve ose humbjeve ndaj menaxhmentit të lartë.
- d) Caktimi i përgjegjësive që ka departamenti i llogarive të arkëtueshme nuk është bërë në mënyrë të qartë.

25. Ka ndodhur një mashtrim në një kompani me madhësi të moderuar kur nëpunësit të kontabilitetit i' u delegua shumë përgjegjësi. Gjatë vitit, kompania ndërroi furnizimin e një shërbimi tek një shitës i ri. Punonjësja e kontabilitetit vazhdoi të paraqiste fatura mashtruese nga furnizuesi i vjetër. Për shkak se kontraktimi për shërbime dhe aprovimi i faturave të furnizuesve ishte deleguar nëpunësit, ishte e mundur që ajo të vazhdonte faturimet nga furnizuesi i vjetër dhe të depozitonte me postë çekun e mëvonshëm, për të cilin ajo ishte përgjegjëse, në një llogari të re që ajo hapi me emrin të furnizuesit të vjetër. Nëpunësi u konsiderua një punonjës i shkëlqyeshëm dhe 'u dha përgjegjësia e shtuar për përgatitjen e buxheteve të departamentit. Kjo përgjegjësi e shtuar i lejoi asaj që në të vërtetë të buxhetojë për shumën e pagesave mashtruese. Testet analitike mund të jenë të dobishme në zbulimin e mashtrimeve.

Cila nga procedurat e mëposhtme analitike ka të ngjarë të ketë sinjalizuar ekzistencën e mashtrimit?

- a) Prodhimi aktual me prodhimin e periudhës paraprake.
- b) Shpenzimet aktuale të shërbimit dhe shpenzimet e periudhës paraardhëse.**
- c) Buxheti në shpenzimet aktuale të shërbimit.
- d) Kostoja e kompanisë së mallrave të shitura në industrinë e kostos së mallrave të shitura.

26. Standardet IAB/IIA kërkojnë që auditorët e brendshëm të kenë njohuri në lidhje me faktorët ("treguesit e pranisë") që kanë dëshmuar se shoqërohen me mashtrim nga menaxhmenti. Cili nga faktorët e mëposhtëm në përgjithësi NUK ka qenë i lidhur me mashtrimet e menaxhmentit?
- a) Sistemet e shpërblimeve të bazuara në performancën bujare.
 - b) Një menaxhim dominues.
 - c) Krahasimi i rregullt i rezultateve aktuale me buxhetet.**
 - d) Preokupimi i menaxhimentit me rritjen e performancës financiare.
27. Një sistem adekuat i kontrolleve të brendshme ka shumë të ngjarë të zbulojë një parregullsi të kryer nga një:
- a) Grupi i punonjësve në bashkëpunim.
 - b) Punonjës i vetëm.**
 - c) Grupi i menaxherëve në bashkëpunim.
 - d) Menaxher i vetëm.
28. Gjatë një auditimi të rregullt të planifikuar të një divizioni të madh të teknologjisë së informacionit (IT), auditori i IT zbulon një algoritëm të ndërlikuar programimi që shton kosto në një program kosto-plus që faturon qeverinë. Shuma e shtuar zinte 95% të të ardhurave neto të divizionit për vitin e fundit. Pas hetimit të mëtutjeshëm, auditori i IT zbulon se vetëm menaxheri i marketingut, menaxheri i divizionit të IT dhe programuesi kanë njohuri rreth algoritmit.
- Kompania ka një divizion të veçantë për të hetuar mashtrimin. Auditori komunikon me menaxhmentin dhe divizionin e veçantë të hetimit të mashtrimit, dhe hetimi i dorëzohet atij grupi. Megjithatë, pas një muaji, bëhet e qartë se menaxhmenti i lartë ka udhëzuar grupin e hetimit që të mos hetoj më tutje. Departamenti i auditimit të brendshëm duhet:
- A. Raportoj menjëherë rrethanat dhe gjetjet e auditorit IT në agjencinë e duhur rregullatorë. qeveritare sepse auditori nuk mundet me vetëdije të jetë palë e një akti të paligjshëm.
 - B. Mos ndërmer asnjë veprim tjetër. Natyra e mashtrimit është raportuar tek autoritetet e duhura brenda kompanisë dhe auditori nuk ka fuqi të ndjekë hetimet më tej.
 - C. Raportoj menjëherë rrethanat dhe gjetjet e auditorit IT tek komiteti i auditimit.**
 - D. Raportoj gjetjet tek auditori i jashtëm sepse auditori i jashtëm duhet të jetë i vetëdijshëm për ndonjë keq-deklarim material të bilancit të llogarisë.
29. Një kompani punësoi një menaxher të llogarive të pagueshme të mbi kualifikuar të cili i' u ishte ndërprerë kontrata nga një kompani tjetër për dyshime për keq bërje. Gjashtë muaj më vonë menaxheri devijoi €12,000 duke dërguar pagesa të kopjuara të faturave të një i afërm. Një kontroll që mund të kishte parandaluar këtë situatë do të ishte:
- A. Kontrolloni si duhet historikun e mëparshme të punësimit për të gjithë punonjësit e rinj.**
 - B. Mos punësoni individë që paraqiten të mbi kualifikuar për një vend pune.
 - C. Verifikoni kualifikimin arsimor për të gjithë punonjësit e rinj.
 - D. Kontrolloni për të parë nëse të afërmit e të punësuarit punojnë për shitësit.

30. Menaxhimi me libra të hapur i lejon punonjësve të shohin vetë - nëpërmjet listave, materialeve të shtypura, takimeve, dhe raporteve - gjendjen financiare të kompanisë. Ai gjithashtu i'u tregon punonjësve individualë se si puna e tyre përshtatet me pamjen e tërë organizatës dhe se si puna në fjalë ndikon në të ardhmen financiare të organizatës. Qëllimi i menaxhimit me libra të hapur është që:

A. secili punonjës të fillojë të mendojë si të ishte pronar i biznesit dhe jo si një i punësuar që nuk e di se nga vijnë e ku shkojnë paratë.

B. të vlerësojë nëse shpenzimet bëhem më shumë për aktivitetet që i shtojnë vlerë apo ato që nuk shtojnë vlerë kompanisë.

C. të tregoj se sa mirë janë duke u menaxhuar burimet dhe kapitali njerëzor për të ardhmen e kompanisë.

D. menaxhmenti të përqendrohet në reduktimin e kostove që kanë të bëjnë me aktivitetet që nuk shtojnë vlera.

31. Cila nga politikat e mëposhtme ka të ngjarë të rezultojë në një mjedis të favorshëm për shfaqjen e mashtrimit?

a) Kontributi në përgatitjes së buxhetit nga punonjësit që janë përgjegjës për përmbushjen e buxhetit.

b) Synime të paarsyeshme të shitjes dhe prodhimit.

c) Një proces i punësimit që shpesh rezulton në refuzimin e aplikantëve të trajnuar në mënyrë adekuate

d) Aplikimi i disa kontrolleve kontabël mbi bazën e një mostre.

32. Menaxhmenti i një banke dyshon se një zyrtar i kredive kohëve të fundit krijonte kredi për kompani fiktive, ka arkëtuar shumat e kredive në llogarinë personale, dhe duke lënë kështu kreditë si të papaguara në kohë. Disa fakte përkatëse në lidhje me zyrtarin e kredisë përfshijnë:

Një standard i lartë jetese, i shpjeguar si rezultat i investimeve të shëndosha dhe mos marrjes së pushimeve.

Një veturë e shtrenjtë personale e marrë përmes kontakteve të biznesit.

Faturat e benzinës dhe të riparimit të paraqitura për një makinë të caktuar të kompanisë që janë më të larta se mesatarja e kompanisë (regjistrat e kilometrazhit u dorëzuan në baza tremujore).

Potenco i se bezdiset me pyetjet e auditorëve.

Mashtrimi i mësipërm ka të ngjarë të zbulohet nga:

a) Analizat e numrit të kredive të bëra nga secili zyrtar kredie.

b) Analiza e vëllimit të përgjithshëm të kredive në shuma monetare nga zyrtari i kredisë.

c) Auditimet e jashtme ose të brendshme të dosjeve të kredisë.

d) Rekonsilimi i gjithsej kredive të mbetura me bilancin e librit të përgjithshëm.

33. Nëse një auditor është duke marr mostrën për të testuar pajtueshmërinë me një politikë të caktuar të kompanisë, cili nga faktorët e mëposhtëm NUK ndikon në nivelin e lejuar të rrezikut të mostrimit?
- A. **Përvoja dhe njohuritë e auditorit.**
 - B. Pasojat negative të papajtueshmërisë.
 - C. Niveli i pranueshëm i rrezikut për të nxjerr një përfundim të gabuar të auditimit.
 - D. Kostoja e kryerjes së procedurave të auditimit në përzgjedhjen e mostrave.
34. Një auditor përzgjedhi një mostër të rastësishme prej 100 artikujsh nga një popullatë prej 2000 artikujsh. Totali i përgjithshëm në euro i mostrës ishte 10,000€ dhe devijimi standard ishte 10€. Nëse saktësia e arritur bazuar në këtë mostër ishte plus ose minus 4,000 euro, vlera minimale e pranueshme e popullatës do të ishte:
- A. 204,000€.
 - B. **196,000€.**
 - C. 199,000€.
 - D. 199,800€.
35. Një auditor përgatiti një letër pune që përbëhej nga një listë e emrave të punonjësve dhe numrave të identifikimit, si dhe deklaratën e mëposhtme: Duke përputhur numrat e rastit me numrat e identifikimit të punonjësve, u zgjodhën 40 dosje të personelit të punonjësve për të verifikuar se dosjet përmbajnë të gjitha dokumentet e kërkuara nga politika e kompanisë. Asnjë përjashtim nuk u vërejt. Auditori nuk ka vendosur shenja shënjuese në këtë letër pune. Cila nga ndryshimet e mëposhtme do të përmirësonte më së shumti letrat e punës të auditorit?
- a) Përdorimi i shenjave shënjuese për të treguar se çdo dosje ishte kontrolluar.
 - b) Heqja e emrave të punonjësve për të mbrojtur konfidencialitetin e tyre.
 - c) **Arsyetimi për madhësinë e mostrës.**
 - d) Lista e dokumenteve aktuale të kontrolluara për secilin punonjës.
36. Devijimi standard i një mostre zakonisht zvogëlohet me:
- a) Një rënie në madhësinë e mostrës.
 - b) **Përdorimin e shtresimit.**
 - c) Një rritje në saktësinë e dëshiruar.
 - d) Një rritje në nivelin e besimit.
37. Sa herë që një auditor i brendshëm nxjerr një përfundim në bazë të dëshmive të marra nga një mostër, krijohet një rrezik shtesë - rreziku i marrjes së mostrave. Një shembull i rrezikut të marrjes së mostrave është:
- a) Projektimi i rezultateve të mostrimit përtej popullatës së testuar.
 - b) Përdorimi i një procedure të gabuar të auditimit me një mostër.
 - c) Zbatimi i gabuar i një procedure auditimi në mostrën e të dhënave.
 - d) **Hartimi i një përfundimi të gabuar nga të dhënat e mostrës.**

38. Një nivel besimi prej 90% do të thotë që:
- Shkalla e pritjes së gabimit është e barabartë me 10%.
 - Vlerësimi i pikës së marrë është brenda 10% të vlerës së vërtetë të popullsisë.
 - Ekzistojnë 90 mundësi nga 100 që rezultatet e mostrës nuk do të ndryshojnë nga karakteristikat e vërteta të popullatës për më shumë se një sasi e specifikuar**
 - Kërkohet një madhësi më e madhe e mostrës sesa nëse niveli i dëshiruar i besimit ishte i barabartë me 95%.
39. Në një anketë rajonale të familjeve në zonat rurale për të marrë të dhëna për zakonet e shikimit të televizionit, fillimisht zgjidhet një mostër statistikore e zonave rurale. Brenda zonave të zgjedhura zgjidhen mostra statistikore të blloqeve të tëra dhe brenda blloqeve të përzgjedhura zgjidhen mostra të rastësishme të familjeve. Ky lloj i përzgjedhjes së mostrës mund të përshkruhet më së miri si:
- Mostrimi sipas veçorive.
 - Mostër e rastësishme e shtresëzuar (e stratifikuar).
 - Mostra bashkësi.**
 - Ndryshore interval.
40. Ju duhet të kontrolloni afatet kohore të pagesës së faturave të blerjes bazuar në një mostër përfaqësuese të çeqeve të shkruara. Popullata e mostrës përbëhet nga gjithsej 967 çeqe me numër të njëpasnjëshëm që janë lëshuar për llogaritë e pagueshme. Metoda më e përshtatshme për nxjerrjen e një mostre të çeqeve është:
- Mostra bashkësi.
 - Ndryshore interval.
 - Mostra e thjeshtë e rastësishme.**
 - Mostër e rastësishme e shtresëzuar (e stratifikuar).
41. Një teknikë e mostrimit statistikor që do të zvogëloj madhësinë e mostrës sa herë që pritet një normë e ulët e mos – përputhshmërisë quhet:
- Mostrimi sipas veçorive.
 - Mostrimi i ndryshoreve.
 - Mostër e rastësishme e shtresëzuar (e stratifikuar).
 - Plani i mostrimit ndal-dhe-shko**
42. Cili nga opsionet në vijim është burimi më i mirë për t' u përdorur nga një ekip auditimi për të identifikuar rreziqet e zakonshme me të cilat përballet një kompani?
- Listat e kontrollit ose listat rikujtuese.
 - Grafikët e rrjedhës.
 - Pyetësorë.
 - Hulumtimet e publikuara në revista profesionale dhe tekste shkollore.**

43. Për të testuar nëse debitimet ndaj llogarive të arkëtueshme përfaqësojnë transaksione që kanë ndodhur, auditori duhet të gjurmojë regjistrimet nga:
- A. Libri i llogarive të arkëtueshme në librin e shitjeve.**
 - B. Libri i shitjeve në librin e llogarive të arkëtueshme.
 - C. Libri i llogarive të arkëtueshme në ditarin e arkëtimeve të parave të gatshme.
 - D. Dokumentacioni i arkëtimeve të parave të gatshme në librin e llogarive të arkëtueshme.
44. Çfarë lloj evidencash paraqesin fotografitë?
- A. Evidenca rrethimore.
 - B. Evidenca të drejtpërdrejtë.
 - C. Evidenca vërtetuese.
 - D. Evidenca thashetheme.**
45. Mënyra më bindës për të vlerësuar kontrollin e cilësisë së prodhimit është:
- a) Vlerësoni numrin dhe arsyet e rregullimeve të shitjeve.**
 - b) Analizoni variancat e efikasitetit të punës.
 - c) Analizoni variancat e efikasitetit të materialeve.
 - d) Vlerësoni përzierjen e prodhimit / inventarit / shitjes.
46. Vëzhgimi konsiderohet një procedurë e besueshme e auditimit por është e kufizuar në dobinë e tij. Sidoqoftë, përdoret në një numër situatash të ndryshme të auditimit. Cila nga pohimet e mëposhtme është e vërtetë në lidhje me vëzhgimin si një teknikë të auditimit?
- a) Rrallëherë është e mjaftueshme për të marrë siguri të arsyeshme për çdo pohim të auditimit përveç ekzistencës.**
 - b) Është metodologjia më e efektshme e auditimit për të përdorur në plotësimin e pyetësorëve të kontrollit të brendshëm.
 - c) Është metodologjia më bindëse për të mësuar se si përpunohen me të vërtetë transaksionet gjatë periudhës nën auditim.
 - d) Është teknika më bindëse e auditimit për të përcaktuar nëse ka ndodhur mashtrimi.
47. Ju jeni një auditor i brendshëm, kompania e të cilit është në proces të blerjes së një kompanie tjetër. Ju është kërkuar që të verifikoni që paratë e gatshme për kompaninë që është blerë janë deklaruar siç duhet. Teknika e auditimit që do të japë dëshmi më bindëse është:
- a) Përgatitja dhe rishikimi i kërkesave standarde të konfirmimit të bankave.**
 - b) Ekzaminimi i llogarisë së mbledhjes së kompanisë.
 - c) Intervistë me thesarin e kompanisë dhe menaxherin e parave.
 - d) Llogaritjet analitike që krahasojnë paratë e gatshme në bankë me periudhat e mëparshme të kontabilitetit.

48. Një auditor i brendshëm po kontrollon funksionin e marketingut të kompanisë. Kompania ka angazhuar një kompani lokale të marketingut me madhësi mesatare për të vendosur reklama në botimet e revistave. Si pjesë e rishikimit të punimeve të auditimit, mbikëqyrësi i auditimit të brendshëm është duke vlerësuar evidencat e mbledhura.

Auditori ekzaminoi kontrollet e brendshme të kompanisë së marketingut dhe, bazuar në anketën paraprake, ka përcaktuar se nuk ka probleme. Mbikëqyrësi beson se duhet të ketë evidenca thelbësore dhe ka vendosur që evidencat e mbledhura deri më tani nuk janë:

- A. Relevante.
- B. Dobishme.
- C. Kompetent.
- D. Mjaftueshme.**

49. Për të identifikuar mungesat e artikujve specifike në një inventar të mallrave të shtrenjta të mbajtura për shitje me pakicë, hapi më i përshtatshëm i punës së auditimit është:

- A. Aplikoni metodën e shitjes me pakicë të vlerësimit të inventarit.
- B. Analizoni nivelet e qarkullimit aktual dhe të mëparshëm të inventarit.
- C. Zhvilloni vlerësime të inventarit bazuar në metodën e përqindjes së fitimit bruto.
- D. Krahasoni numërimin e inventarit fizik me rezultatet në regjistra të inventarit.**

50. Evidenca e auditimit më bindëse në lidhje me vlerën e pasurisë së kompjuterëve të blerë do të ishte:

- A. Bisedimi me menaxhmentin.
- B. Dokumentacioni i përgatitur nga jashtë.**
- C. Vëzhgimi i procedurave të palës së audituar.
- D. Ekzaminimet fizike.